




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës 29.02.2024, ora 10:00.

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i dy procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
4. Propozim-vendim për zëvendësimin e anëtares së Kuvendit znj. Fatbardha Haliti-Mustafa, me anëtares znj. Ervina Vojvoda, si dhe dhënia e betimit, me Nr.01.020/01-0010609/24, të datës 21.02.2024, (Raporton Kryesuesja e Kuvendit znj. **Adelina Spahiu**);
5. Propozim-vendim për zëvendësimin e anëtares së Komitetit për Politik dhe Financa (KPF) znj. Fatbardha Haliti-Mustafa, me Nr.01.020/01-0010606/24, të datës 21.02.2024, (Raporton Kryesuesja e Kuvendit znj. **Adelina Spahiu**);
6. Informatë lidhur me ndryshimet në Zyrën Kadastrale, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër e Pronësi, (Raporton Drejtoresha e DGJKP-së, znj. **Blerta Dobra-Geci**);
Pikë shtesë
7. Informatë lidhur me vendimin Nr. 01-015/01-0018401/23, i datës 05.04.2023, sipas kërkesës së MMPHI-së, (Raporton drejtori i DUMA-së, z. **Driton Mulaj**);
8. Pyetjet e këshilltarëve nën pikën të ndryshme.

Kryesuesja: I nderuar kryetar i komunës z. Fadil Nura, të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, shoqëri civile dhe gjithë ju të pranishëm, shkojmë në konstatime të kuorumit në sallë janë 26 anëtar, mungon me arsye Fikret Rexhepi, Liridona Koci, dhe Avdulla Geci, bashkëngjitën gjate seancës Ragip Durmishi dhe Dardan Shala.

Shkojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, fjalën ja kalojë:

Hysni Mehani-LVV: Fjala përshëndetëse, Kisha kërkua që si "Propozim-Informatë, së sa projekte i ka dërgua komuna e Skenderajt në ministri për bashkëfinancim", që ministri ka bërë thirrje për projekte për bashkëfinancim me Ministrin e infrastrukturës, me na dhënë si informatë se sa projekte i keni dërgua si komunë në ministri të infrastrukturës a i keni dërguar? Dhe në kuadër po të këtyre projekteve kam informacion prej ministrit që asnjëherë nuk është bërë as një kërkesë që ka të bëjë me renovimin e stadiumi dhe ju kisha lutë me bërë një projekt dhe me dërgua në ministri të kulturës, së deri tash nuk e keni bërë, dhe në ndërkohe gjendja aty është shumë e keqe, pra kryesuese si pikë shtesë është "Propozim-Informatë së sa projekte i ka dërgua komuna e Skenderajt në ministri për bashkëfinancim"?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kryetari të Komunës, Fadil Nura: Fjala përshëndetëse, Faleminderit Hysni që e ngrite këtë çështje, po e sqaroje këtu drejtpërdrejt, ministri mundet me bërë thirrje, po është një afat ligjor kur të përpilohet buxheti, dhe ne e kemi dërgua një listë të projekteve dhe nuk është përkrah bash as

një, e kemi dërgua në kuadër të vërshimeve edhe stadiumin e qytetit përmes komisionit qendrorë që i adresohet ministrisë së linjës, nëse ka pas thirrje në diçka zyrtare nuk kemi dhe ku do që kemi diçka zyrtare ne ju njoftojmë.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-LVV: Për besë nuk po dua politik, po është një thirrje e hapur, qoja projektet, që thotë populli leja kilen, po e keni tendencën e jeni te gatshëm me dëmtua qytetin e Skenderajt, veç me thanë s'po na përkrah qeveria, po këto çka po thua ti janë fjalë goje, se ja kam dërgua njëherë e nuk me ka ndihmua e tash nuk ja qoj me kurrë, po inatet personale t'lutëm leni po dërgoja projektet se edhe sot ka afat, e kur ti dërgoni atëherë ke bazë, po dërgoja projektin e stadiumit së është premtim i ministrit, që ku jemi është fjalë publike.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kryetari të Komunës, Fadil Nura: Po flas sepse institucioni funksionon në bazën e një komunikimi zyrtar, jo llafe të gojës, është një thirrje ku jemi dëmtua, ne e kemi fitua grandin jo që na kanë dhënë, unë po flas shume sinqerisht e kemi dërgua komplet infrastrukturën që është dëmtuare nga vërshimet që me ligjin për emergjenca thotë, ti kam pritë ministrat të gjithë dhe janë zotua, dhe në buxhet nuk e kanë shti ashtu qysh thotë ligji dhe të gjithë i kanë kërkesat për projekte, nuk kemi nevojë për demagogji absolutisht, po deri tash nuk kemi diçka zyrtare, po ne momentin që kemi do ju njoftoj, qysh e kemi bërë marrëveshjen me ministrinë Damka.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtorit DUMA-së, Driton Mulaj: Fjala përshëndetëse, Hysni hera e 4 është që është dërgua lista me 19.01.2024, me Nr.05-543 të ministri dhe zv. Ministri, këto projekte; Ujësjiellësi Shipol-Brus shuma 4.7milion€, me projekt me paramas. Ujësjiellësi në BL- Qirez faz 1 dhe 2 shuma 2.5milion€, Asfaltimi i rrugëve neper fshatra Kuqic, Qubrel, Vitak, Kosterrc, Klladerrnic, Burojë, Vajnik, Abri, Ticë, Mikushnic, Polac, Makerrmal, Rakinic, shuma 1,350.000.00€, Asfaltimi i rrugës neper fshatra Terrnafc, Prekaz, Lubavec, Marin, Kryshc, Dashec, Klinë e ultë, shuma 950mijë€, Ndërtimi i urave neper fshatra që janë dëmtuar prej vërshimeve shuma 1,250,000.00€, si dhe për tribuna të stadiumit vitin e kaluar është bërë projekti është lidhë një kontratë në kuadër të komunës dhe projekti ka shkua në ministri të kulturës.

Kryesuesja: Shkojmë në votim për propozimin e Hysni Mehanit që ky propozim të futet në rend dite për miratim, Konstatojmë me (6) vota për, (16) kundër dhe (4) abstenim, nuk futet si pikë shtesë "Propozim-Informatë së sa projekte i ka dërgua komuna e Skenderajt në ministri për bashkëfinancim. Grupi parlamentar i LVV, e kanë bojkotuar seancën.

Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, konstatojmë me (26) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, Miratohet Rendi i Ditës.

Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës,

Shqyrtimi i dy procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara, e hapë debatin për procesverbalin e datës 28.12.2023, nëse nuk ka konstatojmë me (21) vota për, (0) kundër dhe (3) abstenim, miratohet procesverbali i datës 28.12.2023.

Vazhdojmë me procesverbalin e dytë të datës 31.01.2024, e hapë debatin, nëse nuk ka, Konstatojmë me (22) vota për, (0) kundër dhe (2) abstenim, miratohet procesverbali i datës 31.01.2024.

Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës,

-Propozim-vendim për zëvendësimin e anëtares së Kuvendit znj.Fatbardha Haliti-Mustafa, me anëtares znj. Ervina Vojvoda, si dhe dhënia e betimit, me Nr.01.020/01-0010609/24, të datës 21.02.2024, e ftoj znj. Ervina Vojvoda, ta jepe betimin:

Ervina Vojvoda-IDEAL: Fjala përshëndetëse, leximi i betimit, *Unë, (Ervina Vojvoda) "betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas*

ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mija si anëtare e Kuvendit të Komunës së Skenderajt, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë". Faleminderit.

Kryesuesja; Faleminderit, ju njoftoj së Dardan Shala dhe Ragip Durmishi janë bashkan gjithur mbledhjes, shkojmë në votim konstatojmë me (26) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim miratohet Propozim-vendim për zëvendësimin e anëtares së Kuvendit znj.Fatbardha Haliti-Mustafa, me anëtares znj. Ervina Vojvoda, si dhe dhënia e betimit.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit të ditës:

Propozim-vendim për zëvendësimin e anëtares së Komitetit për Politik dhe Financa (KPF) znj.

Fatbardha Haliti-Mustafa, me Nr.01.020/01-0010606/24, të datës 21.02.2024,

znj.Fatbardha Haliti-Mustafa, ka qenë edhe anëtare e Komitetit për Politik dhe Financa nga subjekti politik "Lista e pavarur Bekim Jashari" e njëjta ka ofruar dorëheqjen me shkrim për arsye personale nga Anëtarja e Kuvendit me qenë së e njëjta ka qenë edhe anëtare e Komitetin për Politik e Financa, që dorëheqja nga komiteti është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ Nr.05/2020 për Procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera ne Komunë, përkatësisht neni 12 paragrafi 2 nenparagrafi 2.2, me dorëheqjen e anëtares, e ftojmë një anëtar nga Lista e pavarur Bekim Jashari të jepe një propozim, ftoj:

Naser Bajraktarin-IDEAL: për anëtarët të KPF, propozoj Alketa Mecini.

Kryesuesja: A ka ndonjë propozime tjera, nëse nuk ka konstatojmë me (25) vota për, (0) kundër dhe (1) abstenim miratohet Propozim-vendim për zëvendësimin e anëtares së Komitetit për Politik dhe Financa (KPF) znj. Fatbardha Haliti-Mustafa, me znj. Alketa Mecini, po nga i njëjti subjekt politik, me Nr.01.020/01-0010606/24, të datës 21.02.2024.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit të ditës:

-Informatë lidhur me ndryshimet në Zyrën Kadastrale, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër e Pronësi, (Raporton),

Drejtoresha e DGJKP-së, Blerta Dobra-Geci; Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Informatë lidhur me ndryshimet rrënjësore në Zyrën Kadastrale, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër e Pronësi, të cilat i ka parapa ligji i ri Nr.08/L-237, që tash veç ka hyrë në fuqi, që përmes këtij ligji do të bëhet një organizim vertikal institucional duke përfshirë zyrën kadastrale në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Qytetaret këtu faktikisht do të përfitojnë, po ne si komunë do të humbasim një pjesë të te hyrave vetanake, mirëpo do të krijohen disa lehtësira sa i përket regjistrimit të pronës. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji do të bëhet një organizim vertikal institucional që nënkupton përfshirjen e zyrave komunale kadastrale në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, pra do të bëhet një centralizim institucional nga niveli lokal në nivel qendror. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji do të formohet një komision nga qeveria ku si kompetencë kryesore do të ketë shqyrtimin dhe vendosjen dhe njohjen e zyrtarizmit të te drejtave pronësore jokontistimore mbi pronat e paluajtshme për raste të trashëgimisë, si dhe për njohjen e pronësisë në raste të shitblerjes sipas marrëveshjes jo formale pra gojore të cilat kanë mbet të pa zyrtarizuara, faleminderit jam e hapur për pyetje.

Kryesuesja: Faleminderit, e hape debatin:

Mentor Mehmeti-PDK: Fjala përshëndetëse, Kemi pas diskutim edhe në KPF, drejtoresh i kam disa pyetje; 1. A është praktikuar diku tjetër ky ligj apo është ligj i ri në Kosovë? 2.Zyrtaret kadastral dhe të gjeodezisë a kanë me kanë pjesë e komunës apo kanë me u zhvendos diku tjetër? 3.Qytetaret a kanë me pagua prapë apo janë shërbime falas? Dhe 4., Komuna jonë prej zyrës së gjeodezisë dhe të katastrit i ka pas gati 300mijë € të hyra për komunë vitin e kaluar, tani këto të hyra i kalojnë qeveris, a ka ndonjë marrëveshje që si komunë kemi me marr si grand?

Besart Rrecaj-PDK: Fjala përshëndetëse, besoj që pyetja e dytë e Mentorit po përputhet me atë çka dua me pyet po ma konkretisht, Nëse këta zyrtar po kalojnë në kuadër të katastroit të Kosovës pagesën dhe pagat e tyre a kalojnë në nivel qendror, apo jesin prapë me u bë prej komune?

Naser Bajraktari-IDEAL: Fjala përshëndetëse, unë e dëgjova drejtoreshën edhe koleget, po këtu kompetencat komunale po i marrka qeveria, ne mundem me elaborua qysh dush, po kompetencat e kësaj drejtorie po shkojnë në institucionin qeveritar, pra sa keni mundësi me i mbrojt ju nuk e di.

Drejtoresha e DGJKP-së, Blerta Dobra-Geci; Mentor ky ligj është marr si bazë si ligjet të vendeve të rajonit, dhe këtë e ka parapa niveli qendror jo ne, ndoshta nuk jemi shume të pajtimit po kjo është. Në këtë raste qytetarët do të përfitojnë si shërbimi do të jetë me i shpejtë dhe me efikas, sepse niveli i përgjithësisë ka qenë në nivelin lokal ka kaluar në nivel qendror, dhe përgjithësia do të kaloj drejtpërdrejt në nivel qendror. Zyrtarët do të mbesin këtu, po menaxhimi do të jetë nga niveli qendror. Të hyrat do të kalojnë në nivel qendror.

Kryesuesja: Faleminderit, dikush tjetër, nëse nuk ka konstatohet me (21) vota për, (0) kundër dhe (2) abstenim përkratet Informatë lidhur me ndryshimet në Zyrën Kadastrale, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër e Pronësi.

Vazhdojmë me piken 7 të rendit të ditës:

-Informatë lidhur me vendimin Nr. 01-015/01-0018401/23, i datës 05.04.2023, sipas kërkesës së MMPHI-së, (Raporton drejtori i DUMA-së, z. Driton Mulaj);

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Ne me kërkesë të banoreve ne shume fshatra dhe qytet kemi iniciua procedurën për riemërimin e disa rrugëve, por qe Ministria na ka kërkuar qe mos te vazhdojmë tutje për shkak qe duhet një liste rezerve dhe riemërimet te behën nga ajo liste ti bëjmë riemërimet, dhe ta njoftojmë ministrinë, dhe ashtu do te veprojmë, sepse perveç asaj shkrese kemi kontaktua edhe me Amir Sogojeva dhe do te veprojmë konform kërkesave te tyre.

-Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme, fjalën ja kaloj:

Afrim Kabashi-NSD: Pyetje për ekzekutivin e komunës 1. Pyetje për Kryetarin Fadil Nura: Ne një interviste dhënë për një medium publik ne fund vitin 2023,ku keni folur rrethe ndërtimit parkut biznesit keni theksuar se po pengohet nga banoret e asaj zone. Pyetja ime ndërlidhet se ne cilën faze ka arritur projekti dhe nga cilët banore te cilës zone po pengohet, dhe cilat do te jene masat qe do ti ndërmerre komuna ne raste se vazhdohet me pengesa.

2. Pyetje për Drejtorin e Urbanizmit; A pritët dhe Kure mendoni te filloni te realizoni ne ndriçimin publik ne BL-të Polacit, por edhe fshatrave tjera qe gravitojnë ne komunën tone, një premtim i ekzekutivit ne fillim te mandatit.

3. Për Drejtorin e Bujqësisë, Pyllltarisë dhe Zhvillimit Rural; Drejtor tu kisha lutë që përgjigjet të mi jepesh në aspektin profesional, mos mi jep politikisht, së në seancën e kaluara krejt politikisht mi ke dhëne përgjigjet, -Drejtor a do te vazhdoni me praktiken e njëjte sikurse viteve paraprake, ku ne thirrjet për aplikim për grande si kriter ta keni qe përfituesi i cili ka përfituar ne dy vitet e fundit te mos jete përfitues, por fatkeqësisht ne praktik po ndodhe e kundërta përfitues po kemi te njëjtit vetëm po ju ndërrohen emrat, dhe për këtë besoj qe keni njohuri dhe për këtë keni pasur ankesa nga fermerët. Dhe faleminderit që me kishe thënë që të japi mësimë për projekte, dhe kur të me thirrsh unë ka me ardhur.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Afrim nuk e di nuk po e mbaj në mend çka kam thënë neper medime, po si do që të jetë është e vërtet që parku i biznesit gjatë fazës së shpronësimit nuk e di a ju ka nënshtruar debateve publike me qytetar të asaj zone po ka probleme pronësore ka pretendues dhe shihet që një pjesë e pronave e punojnë tokat që janë pjesë të asaj zone. Po gjatë

fazave të implementimit na duhet një konsultë publike me qytetaret të asaj zone që me i tregua që është interes i tyre.

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Sa i përket projektit të ndriçimit publikë është në kuadër të shërbimeve publike nr.44, i kemi në këtë vite 132mijë €, dhe një pjesë të buxhetit nga fondi i performances, jemi tu e pritë një marrëveshje dhe së shpejti fillon me procedura të prokurimit.

Drejtori i DBPZHR-së, Bexhet Maliqi: Afrim operojmë me dy çështje të formave të grandit me donatorët dhe me mjetet tona, kur kemi punë me donatore komisionet i bëjmë bashkërisht ne e kemi një anëtar, donatori dy anëtar, dhe përgjithësia i bie ati që e ka shumicën, dhe komisioni punon me certifikatë familjare, nuk mundem askujt me ja inpunua me nejt bashke me babën a me ndërrua shpija a vendbanimin, dhe certifikata familjare e përcakton a ka marr grand a jo, nuk kemi raste të ankesave siç i ke cekur ti, të kësaj natyre, dhe sikur të kemi ne duhet me u përgjigj.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Afrim Kabashi-NSD: Kryetar nëse ti e ke harrua, ne mbledhjen e ardhshme ta bij çka ke thënë. Drejtor nifi e përcakton anëtarin e familjes, se veç me një nife drejtohet familja, dhe ankesa drejtor ka pas mos i mshefë

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DBPZHR-së, Bexhet Maliqi: Afrim nuk është ashtu me ligj nuk ke drejtë me ja kufizua askujt mos me qel nif, edhe nuk e përcakton nifi i cilës familje je, veç referoju UA, që janë në fuqi.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Ali Lutfiu-PDK: Kërkesë, Drejtorit të drejtorisë së inspeksionit. Edhe pse mirëmbajtja dhe rregullimi i semaforëve është në kompetencë të ministrisë, qytetarët e lagjes 3 të cilët me se tepërmi e frekuentojnë rrugën Osman Geci ku semaforët e koordinuar gjatë, diku rreth 70 sekonda po paraqesin kolona të gjata, e kjo zakonisht ndodh në orën 16 kur dalin nxënësit nga shkolla. Me kërkesë të banorëve kërkojmë nga ju që të na ndihmoni ta zgjedhim këtë problem. Lus të hasim në mirëkuptim.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DI-së, Valon Haliti: Fjala përshëndetëse, i nderuar i kemi dërguar përmbi 3 kërkesa në ministrin te inspektoratit, për rregullimin e semaforëve, po është mungesë e operatorëve kontraktuarve, kemi kërkuar edhe për vendosjen e disa shirita vibruës në atë rrugë, për arsye së aty rrezikohen kalimtarët, po nuk kemi marr ende përgjigje, po presim.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Abdulla Gashi-IDEAL: 1.Pyetje për drejtorin e inspektoratit, Valon Haliti: Drejtor, a ke mundësi me na tregu a ke ndërmarrë ndonjë mase lidhur me objektin ne rrugën “Ahmet Delija”, qe si pasoje e gropimit për ndërtimin e objektit është duke u rrezikuar prona publike e private dhe objektet përreth, është dëmtuar ne mase te madhe edhe rruga ne atë pjese, dhe a ka pas leje ndërtimi? 2.Pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, Alban Shala: Drejtor, a ke mundësi me u përgjigje ose me na sqarua se çka ke parapare për këtë vit për pastrimin e mbeturinave qe e kane shëmtuar natyrën dhe shëndetin e njeriut, a ke bere ndonjë plan se si do i largoni këto mbeturina inerte ne komunën e Skenderaj-it?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DI-së, Valon Haliti: Për objektin që po flisni, fillimisht e ka pas një leje, po e ka tejkalu atë leje, dhe ka bë disa veprime të cilat kanë shkaktuar dëme në infrastrukturë publike. E kemi shqiptuar një gjobë që është maksimale sipas ligjit në vlerë prej 5 mijë€, operatori kur të pajiset me leje dëmtimet që i ka shkaktuar ka mi kthye në gjendjen e mëparshme.

Drejtori i DSHP-së, Alban Shala: Fjala përshëndetëse, natyrisht sipas planit të punës të vitit 2024 i kemi parapa mirëmbajtjen e hapësirave nga mbeturinat po ashtu edhe nga mbeturinat inerte, dhe

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Afrim Kabashi-NSD: Kryetar nëse ti e ke harrua, ne mbledhjen e ardhshme ta bij çka ke thënë. Drejtor nifi e përcakton anëtarin e familjes, se veç me një nife drejtohet familja, dhe ankesa drejtor ka pas mos i mshefë

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DBPZHR-së, Bexhet Maliqi: Afrim nuk është ashtu me ligj nuk ke drejtë me ja kufizua askujt mos me qel nif, edhe nuk e përcakton nifi i cilës familje je, veç referoju UA, që janë në fuqi.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Ali Lutfiu-PDK: Kërkese, Drejtorit të drejtorisë së inspeksionit. Edhe pse mirëmbajtja dhe rregullimi i semaforëve është në kompetencë të ministrisë, qytetarët e lagjes 3 të cilët me se tepërmi e frekuentojnë rrugën Osman Geci ku semaforët e koordinuar gjatë, diku rreth 70 sekonda po paraqesin kolona të gjata, e kjo zakonisht ndodh në orën 16 kur dalin nxënësit nga shkolla. Me kërkesë të banorëve kërkojmë nga ju që të na ndihmoni ta zgjedhim këtë problem. Lus të hasim në mirëkuptim.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DI-së, Valon Haliti: Fjala përshëndetëse, i nderuar i kemi dërguar përmbi 3 kërkesa në ministrin te inspektoratit, për rregullimin e semaforëve, po është mungesë e operatorëve kontraktuarve, kemi kërkuar edhe për vendosjen e disa shirita vibrues në atë rrugë, për arsye së aty rrezikohen kalimtarët, po nuk kemi marr ende përgjigje, po presim.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Abdulla Gashi-IDEAL: 1.Pyetje për drejtorin e inspektoratit, Valon Haliti: Drejtor, a ke mundësi me na tregu a ke ndërmarrë ndonjë mase lidhur me objektin ne rrugën "Ahmet Delija", qe si pasoje e gropimit për ndërtimin e objektit është duke u rrezikuar prona publike e private dhe objektet përreth, është dëmtuar ne mase te madhe edhe rruga ne atë pjese, dhe a ka pas leje ndërtimi? 2.Pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, Alban Shala: Drejtor, a ke mundësi me u përgjigje ose me na sqarua se çka ke parapare për këtë vit për pastrimin e mbeturinave qe e kane shëmtuar natyrën dhe shëndetin e njeriut, a ke bere ndonjë plan se si do i largoni këto mbeturina inerte ne komunën e Skenderaj-it?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:


Drejtori i DI-së, Valon Haliti: Për objektin që po flisni, fillimisht e ka pas një leje, po e ka tejkalua atë leje, dhe ka bë disa veprime të cilat kanë shkaktuar dëme në infrastrukturë publike. E kemi shqiptuar një gjobë që është maksimale sipas ligjit në vlerë prej 5 mijë€, operatori kur të pajisët me leje dëmtimet që i ka shkaktuar ka mi kthye në gjendjen e mëparshme.

Drejtori i DSHP-së, Alban Shala: Fjala përshëndetëse, natyrisht sipas planit të punës të vitit 2024 i kemi parapa mirëmbajtjen e hapësirave nga mbeturinat po ashtu edhe nga mbeturinat inerte, dhe jemi në shqyrtim të mundësive që me marrë një aksion nëpërmes kompanive publike që me i bë pastrimi i krejt territori prej mbeturinave.

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Abdulla leje ndërtimore aj operator nuk ka është në proces, projekti tash është në rregull në vija ndërtimore, veç nevojitet një pëlqim nga agjencia për emergjenca për me u pajis me leje dhe pa pëlqim emergjencë nuk lëshohet leja.

Kryesuesja; Faleminderit, Dikush tjetër, nëse nuk ka, me kaq mbyllet ky takimi, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit

